

MARREVESHJE EKONOMIKE DYPALESHE

MIDIS

QEVERISE SE REPUBLIKES SE SRQIPERISE

DHE

QEVERISE SE SHTETEVE TE BASHKUARA TE AMERIKES

DATE: June 10, 1992

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERISE TIRANE  
Nr. 4135 Regj.

Vërtetohet fotokopja  
me origjinalin  
TIRANE /2. 07. 2005/



*H. Aliu*

*Kastila*

## MARREVESHEJE EKONOMIKE DYPALESHE

Marreveshje midis Qeverise se Republikes se Shqiperise dhe Qeverise se Shteteve te Bashkuara te Amerikes persa i perket ndihmes ekonomike, teknike dhe te tjera qe ka lidhje me to.

Kjo marreveshje propozon nje strukture ne lidhje me ndihmen ekonomike e teknike e te tjera te lidhura me keto, e cila, bazuar ne nje kerkese nga Qeveria e Republikes se Shqiperise, mund te jepet nga Qeveria e Shteteve te Bashkuara te Amerikes, ne varesi te ligjeve e rregullave te zbatueshm te Shteteve te Bashkuara te Amerikes. Qeveria e Shteteve te Bashkuara t Amerikes dhe Qeveria e Republikes se Shqiperise permes 'kesaj bien dakort se:

1. Misioni diplomatik i Shteteve te Bashkuara te Amerikes ne Shqiperi te zbatoje dhe do te permbushe pergjegjesite e Qeverise se Shteteve te Bashkuara te Amerikes sipas kesaj marreveshje, dhe mund te caktohet per kete gellim nje sektion i ketij misioni diplomatik.

2. Qeveria e Republikes se Shqiperise do te:

(a), te jape kontributin e duhur dhe me marreveshjen e te dyja geverive, sipas mundesive te personelit te saj, burimeve, mjeteve lehtesuese dhe gjendjes se per gjithshme ekonomike, ne cuarjen perpara te gellimeve per te cilat mund te jepet ndihma;

(b) te marre masa te pershatashme per te siguruar perdorimin efektiv te kesaj ndihme;

(c) t'i jap Qeverise se Shteteve te Bashkuara te Amerikes informacion te plote ne lidhje me zbatimin e ndihmes se dhene nga Qeveria e Shteteve te Bashkuara te Amerikes, si dhe cdo lloj informacioni tjeter lidhur me kete qe mund t'i nevojitet per fagesuesve te Qeverise se Shteteve te Bashkuara te Amerikes per te vleresuar natyren, gjeresine dhe efektivitetin e ketyre programeve, projekteve apo operacioneve te ndihmes;

(d) me njoftim te arsyeshem, te lejoje vezhgimin dhe shikimin nga ana e perfagesuesve te Qeverise se Shteteve te Bashkuara te Amerikes, te te gjitha programeve, projekteve dhe operacioneve te ndihmes dhe dokumentave qe i perkasin atyre.

3. Me gellim qe te sigurohet perfitim maksimal per popullin e Republikes se Shqiperise nga ndihma qe do te dergohet sipas kesaj marreveshje dhe me perjashtime per te cilat bien dakort te dyja geverite:

- (a) Cdo furnizim, materiale, pajisje ose fonde te futura ose te marra ne Republiken e Shqiperise nga Qeveria e Shteteve te Bashkuara te Amerikes, ose nga ndonje person ose institucion i financuar nga ajo qeveri, per gellimet e programeve e projekteve te ndihmes qe ndermetten sipas marreveshes do te perjashtohen nga cdo takse pronesie ose perdorimi prone dhe te gjitha taksat e tjera, kerkesat investuese dhe deposituese, dhe kontrolli i valutes ne Republiken e Shqiperise, kur keto furnizime, materiale, pajisje apo fonde perdoren ne lidhje me programe ose projekte te tilla. Importi, eksporti, blerja, perdorimi, ose shitja e ketyre furnizimeve, materialeve, pajisjeve ose fondevet qe kane te bejne me nje program ose projekt te tille do te perjashtohen nga tarifat, taksat doganore, taksat e importit a te eksportit, taksat mbi blerjen ose shitjen e prones dhe taksa te tjera ose detyrime te ngjashme ne Republiken e Shqiperise;
- (b) Asnje takse (nese ne formen e te ardhures, fitimit, biznesit, ose takse tjeter), dogane ose pagese e cfaredo lloji, mbi te ardhuren e nxjerre nga keto programe osè projekte ndihme, nuk do t'i vihet asnje organizate publike ose private qe ka kontrate me ose financohet nga Qeveria e Shteteve te Bashkuara te Amerikes ose ndonje agjenci e saj, dhe eshte e pranishme ne Republiken e Shqiperise per te kryer pune ne lidhje me programet e projekteve e ndihmes te drejtuara nga kjo marreveshje.
- (c) I gjithe personeli (dhe familjet e tyre), pervec shtetasve shqiptar, ose banuesve te perhershem ne Republiken e Shqiperise, qe (1) kane kontrate me ose ja ne punes te organizatave publike ose private ne saj, ose (2) kan kontrate me (duke perfshire kontrata per sherbi me personale) ose financohen nga, ose qe jane punonjes te organizatave publike ose private ne kontrate me ose te financoara nga Qeveria e Shteteve te Bashkuara te Amerikes ose ndonje agjenci e saj, dhe qe jane kete marreveshje, do te perjashtohen nga taksat e te ardhures dhe te sigurimeve shoqerore, te mbledhura sipas ligjeve te Republikes se Shqiperise, qe kane te bejne me te ardhurat e nxjerra nga programet e pronesine, perdorimin, ose shitjen e pasurise se tundshme personale e destinuar per perdorim personal. Ky personel (si dhe familjet e tyre), per nje periudhe prej gjashte muajsh qe nga dita e arritjes ne Republiken e Shqiperise, do te perjashtohen nga taksat doganore e te importit per t. importuara ne Republiken e Shqiperise per perdorimin e tyre personal, dhe nga te gjitha taksat e pagesat e tjera qe kane te bejne me keto artikuj eksportit per te tille artikuj personale. Ky personel gjithashtu do te perjashtohet nga taksat e

(d) Individet, organizatat publike ose private, dhe punonjes te organizatave publike ose private, qe kane kontrate me ose financohen nga Qeveria e Shteteve te Bashkuara te Amerikes, qe jane te pranishem ne Republiken e Shqiperise per te kryer pune ne lidhje me kete marreveshje, do te kene imunitet nga pergjegjesite civile te lidhura direkt me kryerjen e kesaj pune;

(e) Punonjesit e Qeverise se Shteteve te Bashkuara te Amerikes (dhe familjet e tyre), pervec shtetasve apo banuesve te perhershem te Republikes se Shqiperise, qe jane te pranishem ne Republiken e Shqiperise per te kryer pune ne lidhje me kete marreveshje dhe qe nuk jane anetare te misionit diplomatik, do te perjashtohen nga taksat e te ardhures e te sigurimeve shqerore te mbledhura sipas ligjeve te Republikes se Shqiperise dhe nga taksat mbi blerjen, pronesine, perdonimin ose shitjen e prones personale te tundshme te destinuar per perdonim personal. Ky personel (dhe familjet e tyre) do te perjashtohen nga taksat doganore dha ato te import eksportit per artikujt personale, pajisjet dhe furnizime (duke perfshire ushqime, pije dhe duhan), te importuara ne Republiken e Shqiperise per perdonim personal, dhe nga te gjitha taksat e pagesat qe kane te bejne me keta artikuj personale. Ky personel (dhe familjet e tyre) do te kene imunitet nga pergjegjesi kriminale apo civile ne mase te krabasueshme me personelin e atij seksioni te misionit diplomatik te cilit i referohet paragrafi 1 i kesaj marreveshje;

(f) Asgje ne kete marreveshje nuk ka per gellim te preke privilegjet dhe imunitetet e dhena nga Konventa e Vjenes mbi marredheniet diplomatike.

4. Fondet e sjella ne Republiken e Shqiperise per gellim dhenie ndihme lidhur me kete marreveshje, do te jene te konvertueshem ne monedhen e Republikes se Shqiperise ne kursin qe jep sasine me te madhe te kesaj monedhe per dollar, i cili, ne kohen kur behet konvertimi, nuk eshte i paligjshem ne Republiken e Shqiperise.

5. Kjo marreveshje do te hyje ne fugi pas nenshkrimit. Kjo marreveshje mund te korrigojhet ose te rishikohet me pelqimin me shkrim te Qeverise se Shteteve te Bashkuara te Amerikes dhe Qeverise se Republikes se Shqiperise.

6. Kjo marreveshje mund te perfundohet nga secila pale tridhjete dite pasi te jete njoftuar me shkrim gellimi per ta perfunduar marreveshjen. Megjithë perfundimin e saj, kjo marreveshje do te jete e aplikueshme per ndihmen qe jepet para perfundimit.

Ne prani te deshmitareve, te nenshkruarit, me autorizimin e duhur nga geverite e tyre respektive, kane nenshkruar kete marreveshje.

- 4 -

E bere ne Tirane, ne duplikat, ne gjuhen angleze dhe shqipe, te  
dyja tekstet duke qene njesoj autentike, me date 10. 6., 1992.

Per Qeverine e Shteteve  
te Bashkuara te Amerikes

Per Qeverine e  
Republike se Shqiperise

William E. Ryerson  
William E. Ryerson  
Ambasador

Artan Hoxha  
Artan Hoxha  
Minister i Marredhenieve  
Ekonomike me Jashte